



---

**INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES  
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT  
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLANJA**

**QEVERIA E KOSOVËS - GOVERNMENT OF KOSOVO - VLADA KOSOVA**

**MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE  
MINISTRY OF LABOUR AND SOCIAL WELFARE  
MINISTARSTVO RADA I SOCIJALNE ZAŠTITE**

Në përputhje me nenin 1 paragrafi 1.7 pikat (b), (ç) dhe (d) të Rregullores nr. 2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë.

Duke pasur parasysh nenin 9 paragrafi 9.2 dhe 9.3 të Ligjit për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuara në Kosovë.

Duke pasur parasysh mundësinë e ndryshimit eventual të rrethanave, të cilat ndikojnë në shfrytëzimin apo mosshfrytëzimin e pensionit të aftësisë së kufizuar. Me qëllim të krijimit të masave dhe procedurave përkatëse kundër mashtrimit, nga përfituesit e pensionit të aftësisë së kufizuar.

Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale nxjerr këtë:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 7/2005**

***PËR***

**PROCEDURAT ADMINISTRATIVE TË KTHIMIT TË PAGESAVE NGA  
SHFRYTËZUESIT E PENSIONIT TË AFTËSISË SË KUFIZUAR**

**Neni 1**

**Qëllimi i Udhëzimit Administrativ**

1.1. Nxjerrja e këtij Udhëzimi Administrativ, ka për synim krijimin dhe zbatimin e procedurave administrative, për të mundësuar inicimin e procedurave gjyqësore kundër të gjithë personave të cilët janë shfrytëzues të pensionit të aftësisë së kufizuar pa mbështetje

ligjore e cila sigurohet me dispozitat e Ligjit për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuara në Kosovë.

## **Neni 2**

### **E drejta e monitorimit dhe inspektimit**

- 2.1. Të gjithë personat e përzgjedhur si shfrytëzues të pensionit të aftësisë së kufizuar, në përputhje me nenin 2 të Udhëzimit Administrativ për Procedurat e Monitorimit dhe Rishqyrtimit, mund të monitorohen dhe inspektohen në rast se Autoriteti Përkatës dyshon në ndonjë ndryshim eventual të rrethanave të cilat ndikojnë drejtpërsëdrejti në përzgjedhjen e shfrytëzuesit të pensionit të aftësisë së kufizuar.
- 2.2. Të drejtën në monitorim dhe inspektim e kanë komisioni inspektues apo nëpunësit e autorizuar të zgjedhur nga Divizioni Skemave Pensionale të DAPK-së.
- 2.3. Çdo person i cili pengon komisionin inspektues apo nëpunësin e autorizuar për të bërë verifikimin e fakteve të prezantuara në kërkesë, menjëherë do të hiqet nga skema e pensionit të aftësisë së kufizuar.

## **Neni 3**

### **Kthimi i pagesave pensionale**

- 3.1 Nëse gjatë procedurave të monitorimit dhe inspektimit, komisioni inspektues apo nëpunësi i autorizuar i Autoritetit Përkatës, vlerësojnë se faktet e prezantuara në fletaplikacion nuk janë të vërteta apo shfrytëzuesi i pensionit të aftësisë së kufizuar nuk ka informuar Autoritetin Përkatës për ndonjë ndryshim të rrethanave të cilat ndikojnë në të qenurit shfrytëzues i pensionit, në këtë rast shfrytëzuesi i pensionit duhet t'i rikthejë të gjitha pagesat e pensionit të aftësisë së kufizuar apo ato pagesa të cilat i ka marrë nga ndryshimi i statusit të tij.
- 3.2 Çdo person i cili si shfrytëzuesi i pensionit të aftësisë së kufizuar punësohet apo vetëpunësohet është i detyruar t'i rikthejë të gjitha pagesat e pensionit të aftësisë së kufizuar prej ditës së punësimit apo vetëpunësimit.
- 3.3 Çdo person i cili me qëllim prezanton dëshmi të rrejshme apo ndonjë dokument të falsifikuar për marrjen e pensionit të aftësisë së kufizuar, apo nuk e informon Autoritetin Përkatës për ndonjë ndryshim eventual të rrethanave, do të jetë i detyruar që t'i kthejë të gjitha pagesat e pensionit të cilat i ka marrë më parë.
- 3.4 Çdo person i cili është shfrytëzues i pensionit të aftësisë së kufizuar, i cili në të njëjtën kohë përfiton edhe ndonjë pension nga skemat e tjera pensionale është i detyruar që t'i kthejë të gjitha pagesat e pensionit të aftësisë së kufizuar, nga momenti i shfrytëzimit të dy skemave pensionale.
- 3.5 Çdo familje apo anëtar i familjes e/i cili është duke përfituar pensionin e aftësisë së kufizuar pas vdekjes së shfrytëzuesit të pensionit të aftësisë së kufizuar është i detyruar që t'i

kthejë të gjitha pagesat nga momenti i vdekjes së shfrytëzuesit të pensionit të aftësisë së kufizuar.

#### **Neni 4**

#### **Procedurat e kthimit të pagesave pensionale**

4.1 Kur komisioni inspektues apo nëpunësi i autorizuar për monitorim dhe rishqyrtim i Autoritetit Përkatës vlerësojnë se ekziston njëra nga arsyet për kthimin e pagesave sipas nenit 3 të këtij Udhëzimi Administrativ, shfrytëzuesi i pensionit të aftësisë së kufizuar duhet të kthejë të gjitha pagesat e marra pa mbështetje ligjore.

4.2. Me këtë rast komisioni inspektues apo nëpunësi i autorizuar i Autoritetit Përkatës e rekomandojnë shfrytëzuesin e pensionit të aftësisë së kufizuar që brenda afatit prej pesë (5) ditë pune, t'i kthejë të gjitha pagesat pensionale të marra pa bazë ligjore.

4.3 Në qoftë se përfituesi i pensionit të aftësisë së kufizuar, nuk e përfill rekomandimin e Autoritetit Përkatës për kthimin e pagesave në afatin prej pesë (5) ditësh, Autoriteti Përkatës duhet të ndërmarrë hapa të tjerë për kthimin e pagesave.

4.4 Pas skadimit të afatit pesë (5) ditor, Autoriteti Përkatës përmes aktit të veçantë duke potencuar faktet të cilat janë esenciale në largimin e përfituesit nga pensioni i aftësisë së kufizuar, kërkon kthimin e pagesave në afatin prej tridhjetë (30) ditësh, nga shfrytëzuesi i pensionit të aftësisë së kufizuar.

4.5 Nëse edhe pas afatit tridhjetë (30) ditësh përfituesi i pensionit të aftësisë së kufizuar, nuk i kthen pagesat e marra pa mbështetje ligjore, Autoriteti Përkatës përmes Zyrës Ligjore të MPMS-së do të ngrejë padi kundër shfrytëzuesit të pensionit të aftësisë së kufizuar në gjykatën kompetente.

#### **Neni 5**

#### **Kërkesëpadija e Autoritetit Përkatës**

5.1 Procedurën gjyqësore kundër shfrytëzuesit të pensionit të aftësisë së kufizuar, i cili pa mbështetje ligjore e ka shfrytëzuar pensionin e Autoritetit Përkatës fillon me ngritjen e padisë në gjykatën e shkallës së parë.

5.2 Objekti kryesor i kërkesëpadiisë duhet të jetë kthimi i pagesave të pensioneve të shfrytëzuara në mënyrë të kundërligjshme nga përfituesi i pensioneve.

5.3 Objekt tjetër i kërkesëpadiisë duhet të jetë edhe kompensimi i dëmit të cilin i padituri ia ka shkaktuar Autoritetit Përkatës me rastin e moskthimit të pagave të shfrytëzuara pa bazë ligjore, duke u mbështetur në dispozitat ligjore të Ligjit për Marrëdhëniet Detyrimore.

5.4 Autoriteti Përkatës në kërkesëpadi gjithashtu duket të kërkojë edhe shpenzimet procedurale nga i padituri i cili në këtë rast është shfrytëzues i pensionit të aftësisë së kufizuar në mënyrë të kundërligjshme.

**Neni 6**  
**Hyrja në fuqi**

6.1 Ky Udhëzim Administrativ hynë në fuqi, ditën e nënshkrimit nga Ministri i MPMS-së, ndërsa do të aplikohet nga dita kur të fillojnë procedurat e monitorimit dhe rishqyrtimit të së drejtës për pensionet e aftësisë së kufizuar.

**Prishtinë, qershor 2005**

**Ministri i MPMS-së**  
***Ibrahim Selmanj***